



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 495/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) dega në Mamushë, paraqitur kundër Mitat Tac- Anëtar i Vendvotimit dega në Mamushë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) dega në Mamushë

### Arsyetim

Me datën 04.11.2013, KDTP-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se, në VV nga dhoma nr.104 një person ka ardhur dhe më ka sulmuar personalisht edhe pse menaxheri u informua dhe nuk morri masa ndaj tij. Më tutje ka theksuar se nga ora 16:45 deri 19:00 kalonin personat ku kanë hyrë në zyrë për me votuar dhe unë si kryesues nuk morra pjesë në VV pasi që Nahit Bytyqi e morri përsipër kontrollin .

PZAP-i, pasi që ftoi në cilësinë e dëshmitarit Muhamet Bajraktari ka deklaruar se, unë jamë i bindur se në dhomën 3201A/04 nuk është rrahur askush dhe nuk ka pasur asnjë problem.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së parashihet se : *“Mund të apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Me ankesën e parashtruar nga KDTP-ja pretendohet se gjatë procesit të votimit në VV nga dhoma 104 një person me ka sulmuar fizikisht dhe pas gjithë kësaj ngjarje menaxheri nuk morri masa ndaj tij. Më tutje ka shtuar se nga ora 16:45 – 19:00 kanë ndodhur shumë pa rregullsi dhe keqpërdorime.

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, sepse për shkak të mungesës së provave shkelja e supozuar nga parashtruesi i ankesës nuk u vërtetua, me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nga dëshmia e dëshmitarit u vërtetua e kundërta, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 495/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.